



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:004488

Datë: 09.08.2022

Numri i dokumentit: 03309137

**P.nr.56/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda**, kryetari i trupit gjykues Bekim Veliqi, me anëtarët e trupit gjykues Mentor Hajraj dhe Veljko Vucetic, me procesmbajtësin Endrit Hajrizaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.T nga Komuna e ... për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Departamenti për Krime të Rënda PP.II.nr.365/2012 e dt.24.04.2017, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Njazi Rexha, ka prezentuar i akuzuari R.T dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtar av.Bedri Miftari, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366 të KPP-së me dt.04.08.2022 është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.09.08.2022:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari: R.T**, nga i ati R., e ëma S. e gjinisë A., i lindur me dt... në Mitrovicë ku dhe jeton në Lagjen "...", me nr.personal ..., punëtor në ndërmarrjen "...", i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** Me dt.09.03.2010 në Mitrovicë në Lagjen "2 Korriku", pa autorizim ka shitur substancë narkotike – marihuanë M.J në sasi prej 3.80 gram, me çmim prej 5 euro, e cila sasi e marihuanës është gjetur tek M. në xhepin e pantallonave gjatë kontrollit të policisë dhe konfiskuar, po ashtu është bërë edhe kontrollimi i shtëpisë së të akuzuarit Rashit me ç'rast në shupën e tij është gjetur substanca narkotike – marihuanë në peshë prej 0.52 gram dhe konfiskuar.

**Me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPK-së.**

Andaj gjykata në bazë të nenit 3, 6, 11, 15, 34, 42, 43, 44 dhe 64 të KPK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së:

**S H Q I P T O N**

**I. DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 400€(katërqind euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast së i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të

KPRK-së, në zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim duke llogaritur 20€ (njëzet euro) për një ditë të kaluar në burg dhe **DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (2) vitesh**, nëse i akuzuari gjatë kohës së verifikimit nuk kryen vepër tjetër penale.

**II.** Në bazë të nenit 60 të KPK-së të akuzuarit i shqiptohet **DËNIM PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT** ashtu që të akuzuarit në bazë të nenit 282 par.1 dhe 2 nën par.2.4 të KPP-së, lidhur me nenin 229 par.5 të KPRK-së, të akuzuarit i **KONFISKOHET** substanca narkotike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol pesha neto e përgjithshme  $4.32 \pm 0.0001$  gram sipas Raportit të Ekspertimit nga me nr.AKF/2017-0935/2017-849 i dt.11.05.2017 nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, substanca narkotike të shkatërrohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**III.** Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20€ (njëzet euro), paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m i**

### **Aktakuza**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë–Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.365/2012 e dt.24.04.2017, ndaj të akuzuarit R.T nga Mitrovica, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPK –së.

### **Rrjedha e procedurës**

Me dt.26.10.2017, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar ndaj të akuzuarit R.T , gjatë seancës se shqyrtimit fillestar, ka prezantuar Prokurori i Shtetit Njazi Rexha, i akuzuari R.T dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Bedri Miftari. I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar është deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, më pastaj procedura ka vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve të tjera ligjor, është vendosur në raport me kundërshtimin e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit, si kryetari i trupit gjykues konfirmojë se kjo lëndë më është caktuar me dt.02.10.2019, ku pastaj janë ndërmarrë veprime ligjore dhe me dt.04.08.2022 është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor, në këtë seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Njazi Rexha, i akuzuari R.T dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Bedri Miftari dhe dëshmitari M.J, ku i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në mbështetje të nenit 323 par.1 dhe 2 nën par.3.1, 2.2, 2.3 të KPP-së, procedura ka vazhduar me leximin e aktakuzës, i akuzuari pas konsultimit me mbrojtësin e tij është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Kryetari i trupit gjykues pas deklarimit të akuzuarit se e ndien veten fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPK, e ka njoftuar se dënimi për këtë vepër penale është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet, i akuzuari është njoftuar se në mbështetje të nenit 383 par.2 të KPP-së në rast të pranimit të fajësisë nuk mund të ushtrojë ankesës ndaj aktgjykimit për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike por e ka të drejtën ligjore për ankesë për shkak të bazave të tjera të parapara me dispozitat e KPP-së, po ashtu është njoftuar se në këtë fazë të procedurës nuk prezantohen

provat materiale dhe ato personale por ato vlerësohen në rastin e caktimit të dënimit dhe matjes së tij, pranimin e fajësisë Gjykata e vlerëson si rrethanë lehtësuese.

I akuzuari ka deklaruar se i kupton pasojat e pranimit të fajësisë dhe rrethanat lehtësuese që i merr gjykata me rastin e matjes së dënimit dhe i akuzuari qëndron pranë pranimit të fajësisë.

Në mbështetje të nenit 326 par.2 të KPP-së, është kërkuar mendimi i Prokurorit të Shtetit dhe mbrojtësit lidhur me deklarinimin e të akuzuarit për pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, pa presion, në konsultim me mbrojtësin e tij, e në mbështetje të provave që gjenden në shkresat e lëndës propozoj që ta pranojë pranimin e fajësisë ndaj të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se në konsultim me të mbrojturin i cili ka deklaruar se i kupton pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, andaj i kërkoj gjykatës që të merr aktvendim për pranimin e fajësisë.

Pas deklarinimit të të akuzuarit se e ndien vetën fajtor për veprën penale dhe pas njoftimit me pasojat ligjore rreth pranimit të fajësisë, po ashtu pas marrjes të mendimit nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe mbrojtësit të të akuzuarit, sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, trupi gjykues ka fituar bindjen se i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është i vullnetshëm, mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza të prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj trupi gjykues në mbështetje të nenit 326 par.1 e lidhur me nenin 248 par.4 e lidhur me par.1 të KPP-së ka marrë aktvendim duke pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

### **Fjala përfundimtare**

Pasi që trupi gjykues ka pranuar pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, seanca ka vazhduar me paraqitjen e fjalës përfundimtare të palëve dhe mbrojtësit në mbështetje të nenit 326 par.4 e lidhur me nenin 352 të KPP-së.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar nuk është kontestuese se i akuzuari R.T i ka shitur substancë narkotike marihuanë M.J në peshë 4.40 gram, e cila është konfiskuar nga ane e policisë, fakt të cilën nuk e mohon as vet i akuzuari, andaj gjykatës i propozoj që të pandehurin ta shpall fajtor për veprën penale dhe ta gjykoj me dënim sipas ligjit si dhe ti konfiskoj substancën narkotike.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Bedri Miftari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, kërkoj nga Gjykata që gjatë caktimit të lartësisë së dënimit t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese, se vepra të cilën e ka kryer ka mbi 12 vite dhe nga ajo kohë nuk ka kryer vepër tjetër penale, është baba i katër fëmijëve të mitur, është mbajtës i familjes gjashtë anëtarëshe, punon në kompani private si sigurim, andaj gjykata t'i ketë parasysh këto rrethana lehtësuese.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet deklarinimin e mbrojtësit të tij dhe ka shtuar se njëherë ka gabuar dhe më jo, pas këtij rasti më nuk kam ra ndesh me ligjin si dhe ka katër fëmijë.

Pasi që trupi gjykues ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe me që nga palët dhe mbrojtësi nuk kanë pasur propozime të reja për plotësimin e procedurës, kryetari i trupit gjykues në bazë të nenit 357 të KPP-së e ka shpallur përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe i ka njoftuar palët dhe mbrojtësin se me dt.04.08.2022 trupi gjykues do shpallë publikisht, e cila shpallje ka qenë e hapur dhe publike, në prezencë të të akuzuarit, në mungesë të mbrojtësit dhe të Prokurorit të Shtetit.

### **Vlerësimi i pranimet të fajësisë**

Në lidhshmëri të pranimet të fajësisë nga i akuzuarinë vlerësimin dhe analizimin e provave materiale dhe atyre personale që janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale dhe në mbështetje të nenit 361 të KPP-së, gjykata vërtetoi se ekzistojnë prova se në veprimet e të akuzuarit janë konsumuar elementet e veprës penale me të cilën akuzohet, kjo konstatohet nga: procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave e dt.09.03.2010, lista e gjërave të konfiskuara e dt.09.03.2010 nga i akuzuari R.T, lista e gjërave të konfiskuara e dt.09.03.2010 nga M.J, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit M.J e dt.09.03.2010, procesverbali mbi marrjen në pyetje të akuzuarit R.T e dt.09.03.2010, Ekspertiza nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr. ref. AKF/2017/-0935/2017-849 e dt. 24.03.2017, ku konstatohet se dëshmitë D#1 deri në D#2 përmbajnë Kanabisë (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC) pesha neto e përgjithshme  $4.32 \pm 0.0001$  gram dhe fotoalbumi, andaj të gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen – krijohen elementet e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPK –së, ku të gjitha rrethanat si më lart tregojnë gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit**

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata duke u mbështetur në nenin 64 të KPK-së sipas rregullave të përgjithshme për matjen e dënimit, në caktim të dënimit me kusht, duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimit si rrethana lehtësuese për bazë mori pranimin e fajësisë nga i akuzuari, prind i katër fëmijëve, mbajtës i familjes, nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar mbi 12 vite, Gjykata në vlerësim të rrethanave të theksuara si më lart i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar me bindjen të plotë se me dënimin e shqiptuar me kusht do të arrihet qëllimi i këtij dënimi i paraparë sipas nenit 34 dhe nenit 42 të KPK-së, duke pasur efektin në parandalimin e kryeseve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcënmin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej veprë tjetër penale andaj Gjykata nga të gjitha këto ka konsideruar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

### **Dënimi plotësues**

Gjykata të akuzuarit i shqiptojë dënim plotësues *Marrja e sendit* në mbështetje të nenit 60 të KPK-së dhe lidhur me nenin 282 par.1 e lidhur me par.2 nën 2.4 të KPP-së ku përcakton se *“Pasuria që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, pa marrë parasysh gjetjet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose trupit gjykues lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit” ... “Pasuria nga paragrafi 1. të këtij neni përfshinë:” ... “kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 272-282 të Kodit Penal”,* substanca narkotike bimore - marihuanë

(sipas Ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. ref. AKF/2017/-0935/2017-849 e dt. 24.03.2017 në peshë të përgjithshme prej  $4.32 \pm 0.0001$  gram, do të shkatërrohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 453 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 39 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr.05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të cekurat si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**P.nr.56/17 dt.09.08.2022**

**Procesmbajtësi**  
**Endrit Hajrizaj**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari**  
**Bekim Veliqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.